**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA VLORË**
**DREJTORIA JURIDIKE**

Nr. 4309 prot.                                                            Vlorë, më 21.03.2024

**PROJEKT-VENDIM**
Nr. _____, Datë, _______2024

**"PËR NJË SAKTËSIM NË VENDIMIN NR.96, DATË 07.12.2023 I KËSHILLIT TË BASHKISË VLORË"**
**"PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË TERRITORIN E BASHKISË VLORË PËR VITIN 2024"**

Bazuar në Ligjin nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 8, Neni 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat "a" dhe "b" nenin 29, pika 3 dhe 4 , neni 54 shkronja "k" dhe neni 55 pika 2 dhe 6, në Ligjin nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" si edhe në Ligjin nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e dates

**V E N D O S I:**

1. Në Kreun IV, Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë për ndërtimet e reja, pika 1.2 "Për objektet që ndodhen në vijë të parë përgjatë rrugës "Sazani", rrugës "Gjergj Kastrioti"(Transballkanike), bulevardi "Ismail Qemali" dhe rrugës "Pelivan Leskaj", si edhe zona nga rruga "Pelivan Leskaj" deri në Njësinë Administrative Orikum, sipas hartës bashkëlidhur përjashtuar pikën 1.1, të V.K.B nr.96, datë 07.12.202 "Për miratimin e taskave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vlorë për vitin 2024", të bëhet saktësimi si më poshtë:

   Në lidhje me pikën 1.2 te tabelës së miratuar për Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë, do të saktësohet harta me legjenden përkatëse per secilën nga rrugët qe preken nga ndryshimi i Taksës të Ndikimit në Infrastrukturë, i miratuar në mbledhjen e datës 07.12.2023.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Urbanistikës dhe Administrata e Bashkisë Vlorë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë, bazuar në Ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 55, pika 6.

Konceptoi: *S.Kalemi*

Miratoi: *D.Demiri*

**KRYETAR**

**Ermal Dredha**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VLORË -

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**BASHKIA VLORË**

**DREJTORIA JURIDIKE**

Nr.4309 prot. Vlorë, më 21.03.2024

# RELACION

## MBI PROJEKT-VENDIMIN "PËR NJË SAKTËSIM NË VENDIMIN NR.96, DATË 07.12.2023 I KËSHILLIT TË BASHKISË VLORË " "PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NE TERRITORIN E BASHKISË VLORË PËR VITIN 2024"

**PARA KËSHILLIT TË BASHKISË**

**Të nderuar Këshilltarë!**

Projekt -Vendimi që ju paraqesim për miratim ka të bëjë me një saktësim te hartës në Vendimin nr.96, datë 07.12.2023 i Këshillit të Bashkisë Vlorë "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore ne territorin e Bashkisë Vlorë për vitin 2024" konkretisht në Kreun IV, Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë për ndërtimet e reja, pika 1.2 "Për objektet që ndodhen në vijë të parë përgjatë rrugës "Sazani", rrugës "Gjergj Kastrioti"(transballkanike), Bulevardi "Ismail Qemali" dhe Rrugës "Pelivan Leskaj" si edhe zona nga rruga "Pelivan Leskaj" deri në Njësinë Administrative Orikum, përjashtuar pikën 1.1.

Saktësimi konsiston kryesisht si më poshtë:

**Me ngjyrë te verdhë - Vija e parë përgjatë rrugës "Sazani"**
**Me ngjyrë te kuqe - Vija e parë përgjatë rrugës "Gjergj Kastrioti" (Transballkanike)**
**Me ngjyrë jeshile - Vija e parë përgjatë Bulevardit "Ismail Qemali"**
**Me ngjyrë lejla - Vija e parë përgjatë Bulevardit "Pelivan Leskaj"**
**Me ngjyrë portokalli - Zona nga rruga "Pelivan Leskaj" deri në Njësinë Administrative Orikum, përjashtuar piken 1.1.**

Ju sqarojmë se, nuk ka ndryshime të zonave nga cfarë kemi parashikuar ne vendimin nr.96, datë 07.12.2023 por kemi bërë një evidentim më të qartë të këtyre zonave, me legjendën përkatëse, të cilat do ti nënshtrohen përllogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infarstrukturë në masën 6% të çmimit të shitjes.

Në këto kushte, kërkojmë prej jush miratimin e këtij Projekt-Vendimi duke vlerësuar në një vendimmarrje pozitive në shërbim të komunitetit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Konceptoi:*S.Kalemi*

Miratoi:*D.Demiri*

**KRYETAR**

**Ermal Dredha**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VLORË

PLANI I PERGJITHSHEM I BASHKISE VLORE
HARTA E 5 SISTEMEVE TERRITORIALE - MIRATUAR ME VENDIM NR.1, DATE 16.10.2017

SHK. 1:750




VIJA E PARE - SHETITORE BREGDETARE "LUNGOMARE 1 - 2"
TABELA NR. 4, PIKA 1.1

SHK. 1:7500




NJESIA ADMINISTRATIVE ORIKUM - ORIKUMI
QYTETI ORIKUM SIPAS PPV - VLORE

SHK. 1:7500




# REPUBLIKA E SHQIPERISE
# BASHKIA VLORE

## DREJTORIA E URBANISTIKES

**KLAUDIO MEHMETAJ**

Harta e takses se ndikimit ne infrastrukture sipas tabeles ne piken 4 paraqitur ne projekt vendim per Paketen Fiskale 2024

NJESIA ADMINISTRATIVE ORIKUM - FSHATI DUKAT
FSHATI DUKAT SIPAS PPV - VLORE

SHK. 1:7500




NJESIA ADMINISTRATIVE QENDER - FSHATI ZVERNEC
FSHATI ZVERNEC SIPAS PPV - VLORE

SHK. 1:7500




NJESIA ADMINISTRATIVE ORIKUM - FSHATI TRAGJAS
FSHATI TRAGJAS SIPAS PPV - VLORE

SHK. 1:10000




NJESIA ADMINISTRATIVE ORIKUM - FSHATI DUKAT I RI
FSHATI DUKAT I RI SIPAS PPV - VLORE

SHK. 1:7500




NJESIA ADMINISTRATIVE ORIKUM - FSHATI RADHIME
FSHATI RADHIME SIPAS PPV - VLORE

SHK. 1:7500




NJESIA ADMINISTRATIVE QENDER - FSHATI KANINE
FSHATI KANINE SIPAS PPV - VLORE

SHK. 1:10000



PLANI I PERGJITHSHEM I BASHKISE VLORE
HARTA E 5 SISTEMEVE TERRITORIALE - MIRATUAR ME VENDIM NR.1, DATE 16.10.2017
SHK. 1:750



- Vija e parë përgjatë rrugës “Sazani”
- Vija e pare pergjate rrugës “Gjergj Kastrioti” (Transballkanike),
- Vija e pare pergjate Bulevardit “Ismail Qemali”
- Vija e pare pergjate rrugës “Pelivan Leskaj”
- Zona nga rruga “Pelivan Leskaj” deri në Njësinë Administrative Orikum

VIJA E PARE - SHETITORE BREGDETARE "LUNGOMARE 1 - 2"
TABELA NR. 4, PIKA 1.1
SHK. 1:7500




NJESIA ADMINISTRATIVE ORIKUM - ORIKUMI
QYTETI ORIKUM SIPAS PPV - VLORE
SHK. 1:7500




# REPUBLIKA E SHQIPERISE
# BASHKIA VLORE

## DREJTORIA E URBANISTIKES

**KLAUDIO MEHMETAJ**

Harta e takses se ndikimit ne infrastrukture sipas tabeles ne piken 4 paraqitur ne projekt vendim per Paketen Fiskale 2024

NJESIA ADMINISTRATIVE ORIKUM - FSHATI DUKAT
FSHATI DUKAT SIPAS PPV - VLORE
SHK. 1:7500




NJESIA ADMINISTRATIVE QENDER - FSHATI ZVERNEC
FSHATI ZVERNEC SIPAS PPV - VLORE
SHK. 1:7500




NJESIA ADMINISTRATIVE ORIKUM - FSHATI TRAGJAS
FSHATI TRAGJAS SIPAS PPV - VLORE
SHK. 1:10000




NJESIA ADMINISTRATIVE ORIKUM - FSHATI DUKAT I RI
FSHATI DUKAT I RI SIPAS PPV - VLORE
SHK. 1:7500




NJESIA ADMINISTRATIVE ORIKUM - FSHATI RADHIME
FSHATI RADHIME SIPAS PPV - VLORE
SHK. 1:7500




NJESIA ADMINISTRATIVE QENDER - FSHATI KANINE
FSHATI KANINE SIPAS PPV - VLORE
SHK. 1:10000

